



---

**“ILLYRIAN GUARD” SH.A.**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT )**

Drejtuar: *Vojsava Zenelaj ,Bulevardi Gjergj Fishta,Kulla Nr.2,kati i dyte,Tiranë.*

Procedura e prokurimit/lotit:E hapur Marrëveshje Kuadër me Lote Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:Loti 2 Veshje REF-55504-12-29-2022 “Uniforma”.

Publikimet e mëparshme : Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Enea Masllavica L71920001R  
Vlera *31.849.500(tridhjetë e një milion e teteqind e dyzet e nëntë mijë e pesqind ) lekë pa Tvsh.*

2.Univers Promotions Sh.P.K K81324039M  
Vlera *31,235,500 (tridhjetë e një milion, e dyqind e tridhjetë e pesë mijë, e pesëqind ) lekë pa Tvsh.*

3.Vojsava Zenelaj L12330004A  
Vlera *31.981.700 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh.*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Enea Masllavica L71920001R  
Vlera *31.849.500(tridhjetë e një milion e teteqind e dyzet e nëntë mijë e pesqind ) lekë pa Tvsh.*

Nuk ka dorezuar Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit

Nuk ka dorezuar sigurimin e ofertes

Nuk ploteson Kapacitetin ekonomik dhe financiar sepse:

Nuk ka dorëzuar vlerën e xhiros minimale vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021

Nuk ka paraqitur dëshmi të furnizimeve të mëparshme

Nuk ka deklaruar nëse janë ose jo prodhues të artikujve objekt prokurimi

Nuk ka paraqitur ISO 9001:2015

Nuk ka paraqitur ISO 450001:2018

Nuk ka paraqitur disponueshmërinë mbi stafin e kërkuar, konkretisht: një inxhinier tekstil dhe një stilist/modelist

Nuk ka paraqitur certifikatën OEKO-TEX

Nuk ka paraqitur mostra fizike, as testime zyrtare

Nuk ka paraqitur certifikatën sipas rregullores EU nr. 425/2016

Nuk ka paraqitur deklaratë mbi garancinë e artikujve objekt prokurimi

Nuk ka paraqitur deklaratë mbi dorëzimin e mallrave objekt prokurimi pranë magazinës së AK - Faza: Kriter i përgjithshëm

2.Univers Promotions Sh.P.K

K81324039M

*31,235,500 (tridhjetë e një milion, e dyqind e tridhjetë e pesë mijë, e pesëqind ) lekë pa Tvsh.*

Operatori Ekonomik nuk plotëson kriterin nr. 5 “OE duhet të paraqesin certifikate OEKO-TEX ose ekuivalent, për produktet (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit)”, sepse:

- OE Univers Promotions shpk ka paraqitur në formularin e vetëdeklarimit se do të mbështetet tek Operatori Zona Tex (Seksioni B “Deklaratë”, Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori teknik, 2.3. Kapaciteti teknik, nën-pika 4 ku ka specifikuar “Të paktën një stilist/modelist”
- Në SPE është dorëzuar një certifikatë OEKO-TEX, lëshuar në emrin e subjektit “Merketeks Tekstil San”.
- AK ka kërkuar që certifikata OEKO-TEX duhet të jetë e lëshuar në emër të operatorit ekonomik kryesor ose të prodhuesit të artikujve.
- OE Univers ka deklaruar se artikujt do të prodhohen nga Zona Tex
- OEKO TEX duhet të ishte e lëshuar ose në emrin e Univers Promotions, ose në emrin e Zona TEX.
- Merketeks Tekstil nuk është as OE kryesor, as operator prodhues i artikujve.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin nr. 7.

Dokumenti i dorëzuar konsiston në Deklaratë të firmosur nga vetë prodhuesi Zona Tex, ndërkohë AK ka kërkuar “Çertifikatë të lëshuar sipas rregullores së miratuar të BE për të përmbushur kërkesat sipas Rregullores EU nr. 425/2016”.

Operatori Univers Promotion ka dorëzuar mostrat fizikisht, ku rezulton se 4 elemente kane mangesi si me poshte:

1. Këmishë me Mëngë të Shkurtër Copë 1

Problematika

- Ngjyra e Kopsave jo ngjyrë Gri sipas Kërkesës
- Nuk është ruajtur palosja e këmishës në xhepin e anës së djathtë
- Jaka nuk është simetrike me qepjen e anëve të këmishës prapa

2. Këmishë me Mëngë të Gjata Copë 1

Problematika

- Ngjyra e Kopsave eshte jo ngjyrë Gri, ndersa AK ka kerkuar kopsa ngjyre gri
- Jaka e deformuar nuk shtrihet dhe nuk ruan formën

3. Kapele Copë 2 Njëra 100% Pambuk, tjetra 100% Poliester

Problematika

- Kapelja e pambukut ngjyrë jo sipas kërkesës

4. Logo 2 Spaleta, Emblema 1

Problematika

- Emblemës i mungon Shkrimi Illyrian Guard
- Spaletat jashtë standartit dhe kërkesës së DST (ngjyra e kornizes se tyre nuk perputhet)
- Mungon Numri Personal - Faza: Kriter i pergjithshem

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme , informojmë [Vojsava Zenelaj me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dyte, Tiranë ] se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 31.981.700 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Rruga: Ibrahim Rugova, ish Garda e Republikës, Tiranë, Website: [www.illyrianguard.al](http://www.illyrianguard.al) / E-mail: [info@illyrianguard.al](mailto:info@illyrianguard.al)] sigurimin e kontratës, si dhe te gjithë dokumentat siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [31.981.700 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**ADMINISTRATORI**

**Robert Lili**

Njesia Prokurimit

Gazmir Spahiu

Anduen Nrejaj

Sokol Dinaj